

AKT THEMELIMI

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" Superior Supplies sh.p.k "

Sot, më datë 14.05.2024,

Arjet Halili, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 11/05/1992, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BD1595868 dhe Nr. Personal J20511085Q zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe në përputhje me të.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është "**Superior Supplies sh.p.k**". Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve dhe jo vetëm, do të shënohet emri "**Superior Supplies sh.p.k**".

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Tregëti me shumicë dhe pakicë e artikujve ushqimorë dhe industrial. Markete dhe Supermarkete. Tregëti e automjeteve dhe të tjera. Import-Eksport.

NENI 3

Emri dhe vula e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin "**Superior Supplies sh.p.k**" dhe kompania do ketë vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Objektivi i shoqërisë do jetë: Tregëti me shumicë dhe pakicë e artikujve ushqimorë dhe industrial. Markete dhe Supermarkete. Tregëti e automjeteve dhe të tjera. Import-Eksport.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Shkodrës me adresë: Lagjja Danjel Matilja, Nr pasurie 11/557, zona kadastrale 8594.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën **100,000** (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë të vetme, ku kuota ka vlerën 100,000 lekë.

Ortaku i vetëm themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin "**Superior Supplies sh.p.k**" zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Arjet Halili, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 11/05/1992, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BD1595868 dhe Nr. Personal *J20511085Q*, zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% të kapitalit, ku një kuotë ka vlerën 100,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakut shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit Nr 9901, datë 14/04/2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - Organi më i lartë vendimarrës.

Administratori - Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

NENI 9

Caktimi i Administratorit

Administrator caktohet **Z. Arjet Halili**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 11/05/1992, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr BD1595868 dhe Nr. Personal *J20511085Q* me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi te kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritje e degëve apo filialeve të saj do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen në Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues, nënshkruhet pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU THEMELUES

Arjet Halili

